

## Titulli i lëndës: Ruajtja e ujit dhe efikasiteti i ujit

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit
Titulli i lëndës:	Ruajtja e ujit dhe efikasiteti e ujit
Niveli:	Master
Statusi i lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I/Semestri II
Numri i orëve në javë:	2 + 2
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	Sipas orarit
Mësimdhënësi:	Prof. Figene Ahmedi
Të dhënat kontaktuese:	Email: <a href="mailto:figene.ahmedi@uni-pr.edu">figene.ahmedi@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	Në përgjithësi, lënda trajton nevojën për menaxhim të qëndrueshëm të resurseve ujore. Lënda ofron një pasqyrë të koncepteve bazë të ruajtjes së ujit dhe efikasitetit të ujit. Temat e mbuluara: Hyrje në ruajtjen e ujit, analizat e problemeve të shkaktuara nga menaxhimi i dobët i ujit, zhgjidhjet e bazuara në natyrë (nature based solutions, NBS) për ruajtjen e ujit, trajtimin, ripërdorimin dhe riciklimin e ujit, ripërdorimin e ujërave të zeza shtëpiake dhe të vogla komerciale, instrumentet, matja e rrjedhjes dhe shpenzimit.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Rritja e kërkesës për menaxhim të qëndrueshëm të ujit në përgjithësi në vendin tonë imponon nevojën për të siguruar disponueshmërinë e ujit për brezat e ardhshëm. Objektivat mësimore të kësaj lënde janë: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rëndësia e ruajtjes së ujit dhe efikasitetit të ujit</li> <li>• Krijimi i një procesi për të informuar, përfshirë dhe edukuar publikun (aktorët/at) mbi çështjet që lidhen me ruajtjen e ujit.</li> <li>• Transferimi i njohurive për ruajtjen e ujit te përdoruesit dhe operatorët e ujit.</li> </ul>
<b>Rezultatet e pritshme të nxënies:</b>	Deri në fund të lëndës, studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësojnë dhe përdorin informacionin e mbledhur nga studimet dhe aplikimet e literaturës shkencore në lidhje me ruajtjen e ujit dhe efikasitetin e ujit.</li> <li>• Analizojnë teknologjitë e ruajtjes dhe përcaktojnë hapat për kursimin e ujit.</li> <li>• Identifikojnë problemet dhe mendojnë në mënyrë inovative për mënyrat për të kursyer ose ripërdorur ujin.</li> <li>• Përgatisin një prezantim dhe raport në anglisht për ruajtjen e ujit – raste studimore mbi menaxhimin e dobët të ujit; menaxhimin e qëndrueshëm të ujit dhe NBS (Komunikimi dhe Kompetenca Sociale).</li> </ul>
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me Rezultatet e Nxënies të studentit)</b>	

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë/Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori/Punë në laborator/Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	2	15	30
Konsultime me mësimdhënësin	1	6	6
Puna në terren			
Testi, punimi seminarik	2	2	4
Detyrë shtëpie	2	12	24
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)			8
Përgatitja për provimin final			10
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)			8
Projektet, prezantimet, etj.			
<b>Total</b>			<b>150</b>

**Metodat e mësimdhënies:** Lënda zhvillohet përmes ligjëratave të ofruara në formë skripte, ushtrimeve në klasë dhe në shtëpi.

**Metodat e vlerësimit:** Vlerësimi i punimit seminarik: 0-100 %  
Vijimi i rregullt – vendimtar në rastet kufitare  
Provimi final: 70 %

**Literatura primare:** Ahmedi, F. Shenime te ofruara ne gjuhen angleze

**Literatura shtesë:**

1. Sturman, J et al., Water Auditing and Water Conservation, 2004, IWA, UK.
2. Seneviratne, M. A Practical Approach to Water Conservation for Commercial and Industrial Facilities, 2007, Elsevier Ltd.

Java	Titulli i ligjëratës
<b>Java 1:</b>	Hyrje në ruajtjen e ujit dhe efikasitetin e ujit
<b>Java 2:</b>	Analiza e problemeve të shkaktuara nga menaxhimi i dobët i ujit
<b>Java 3:</b>	Kursimi i ujit: Hap pas hapi
<b>Java 4:</b>	Sasia dhe cilësia e ujit
<b>Java 5:</b>	Përdorimi i ujit në sektorë të ndryshëm
<b>Java 6:</b>	Ruajtja e ujit në sektorë të ndryshëm
<b>Java 7:</b>	Zgjidhje bazuar ne natyre (Nature based solutions, NBS)
<b>Java 8:</b>	Zgjidhje bazuar ne natyre (Nature based solutions, NBS) (vazhdon)
<b>Java 9:</b>	Trajtimi, ripërdorimi dhe riciklimi i ujit Trajtimi, ripërdorimi dhe riciklimi i ujit
<b>Java 10:</b>	Trajtimi, ripërdorimi dhe riciklimi i ujit Trajtimi, ripërdorimi dhe riciklimi i ujit (vazhdim.)
<b>Java 11:</b>	Ripërdorimi i ujërave të zeza shtëpiake dhe të vogla komerciale
<b>Java 12:</b>	Instrumentimi, matja e rrjedhës dhe konsumit
<b>Java 13:</b>	Instrumentimi, matja e rrjedhës dhe konsumit (vazhd.)
<b>Java 14:</b>	Prezentim: Praktikat e ruajtjes së ujit
<b>Java 15:</b>	Prezentim: Praktikat e ruajtjes së ujit

### **Politikat akademike dhe Kodi i Sjelljes**

*Ora mësimore fillon dhe përfundon me kohë.*

*Mjetet që përdorën gjatë orëve të mësimit duhet të pastrohen dhe të ruhen në fund të orës mësimore.*

*Telefonat mobil/të mençur dhe pajisjet tjera elektronike (p.sh. iPod-ët) duhet të fikën (apo të kurdisen në vibrim) dhe të mos ekspozohen gjatë orëve të mësimit.*

*Laptopët dhe kompjuterët tabletë lejohen të përdorën vetëm në heshtje; aktivitetet tjera siç janë kontrollimi i e-mailit personal apo shfletimi i ueb-faqeve në internet janë të ndaluara.*